# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

www.qpz.gov.al

| Akte të papublikuara | Ekstra 37 | 2009 |
|---|---|---|

Vendime të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, datë 29.9.2009 | Ankimi nr.35720/04 dhe 42832/06 "Çështja Vrioni e të tjerë kundër Shqipërisë dhe Italisë"..... | 3 |
| Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, datë 29.9.2009 | Ankimi nr.32907/07 "Çështja Gjyli kundër Shqipërisë"..... | 13 |

SEKSIONI I KATËRT

ÇËSHTJA VRIONI E TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË DHE ITALISË

(Ankimi nr.35720/04 dhe 42832/06)

VENDIM

(themeli)

STRASBURG

(29 shtator 2009)

Ky vendim bëhet i formës së prerë në rrethanat e parashikuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund të jetë objekt rishikimi redaktorial.

Në çështjen Vrioni dhe të tjerë kundër. Shqipërisë dhe Italisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), me trup gjykues të përbërë prej:

Nicolas Bratza, President
Lech Garlicki
Giovanni Bonello
Ljiljana Mijović
David Thór Björgvinsson
Ledi Bianku
Mihai Poalelungi, gjyqtarë,
dhe Lawrence Early, sekretar i seksionit,
pas shqyrtimit me dyer të mbyllura, më 8 shtator 2009,
merr në këtë datë vendimin e mëposhtëm:

PROCEDURA

1. Çështja e ka origjinën në dy aplikime kundër Republikës së Shqipërisë dhe të Italisë, të depozituara në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (Konventa), si më poshtë vijon: aplikimi nr.35720/04, Vrioni, i datës 8 prill 1999; aplikimi nr.42832/06, Vrioni dhe të tjerë, i datës 15 gusht 2006.

2. Ankuesit u përfaqësuan nga znj. Ms L. Sula dhe nga znj. E. Qirjako, avokatë që ushtrojnë profesionin në Tiranë. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjentja e saj në atë kohë, znj. S. Meneri.

3. Ankuesit pretendonin cenim të nenit 6 § 1 të Konventës, nenit 1 të protokollit nr.1 të konventës dhe nenit 13 i marrë në lidhje me nenin 1 të protokollit nr.1.

4. Më 9 shkurt 2006 dhe më 8 janar 2007, presidenti i seksionit të katërt të Gjykatës vendosi të njoftonte Qeverinë e Shqipërisë për aplikimin nr.35720/04 dhe aplikimin nr.42832/06. Sipas dispozitës së nenit 29 § 3 të Konventës, u vendos që themeli i çështjeve të shqyrtohej në të njëtën kohë me pranueshmërinë e tyre.

5. Ankuesit dhe Qeveria dërguan secili vëzhgimet e tyre të mëtejshme me shkrim (rregulli 59 § 1).

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

6. Z. Shahin Vrioni, ankuesi, në aplikimin nr.35720/04, është nënshtetas shqiptar, i lindur në vitin 1925 dhe jeton në Shqipëri. Z.Gherardo La Francesca, z. Dario La Francesca dhe z. Oliver Vrioni, ankuesit, në aplikimin nr.42832/06, janë nënshtetas shqiptarë dhe italianë, të lindur përkatësisht në vitin 1946, 1950 dhe 1974, të cilët jetojnë në Itali. Z. Shahin Vrioni përfaqësoi veten dhe ankuesit e tjetë në proceset e gjykatave të brendshme.

**A. Sfondi i çështjes**

7. Në vitin 1950 autoritetet shqiptare konfiskuan pa kompensim një sipërfaqe toke prej 1 637 metrash katrorë që i përkiste paraardhësit të ankuesve.

8. Më 1 korrik 1991 ambasada italiane në Shqipëri bleu dy ndërtesa në Tiranë, në kufi të pronës që i ishte konfiskuar gjyshit të ankuesit. Transaksioni u krye nëpërmjet një marrëveshjeje

ndërshtetërore, që u bë e vlefshme nëpërmjet shkëmbimeve të notave verbale ndërmjet të dyja qeverive. Nota verbale nuk përmbante asnjë informacion në lidhje me transferimin e titullit për sipërfaqet rrethuese ose fqinje të tokës. Titujt përkatës të pronësisë nuk ishin hedhur në regjistrin e pronave të Tiranës.

9. Si rrjedhojë, qeveria shqiptare përdori të ardhurat nga transaksioni për të blerë mjediset e ambasadës shqiptare në Romë.

10. Sipas aktit për kthimin dhe kompensimin e pronës (akti i pronës), ankuesit depozituan dy ankesa përkatësisht në vitin 1996 dhe 1999 në Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (Komisioni), nëpërmjet të cilave kërkonin titullin e pronësisë të gjyshit të tyre të sëmurë.

11. Më 18 mars 1996 dhe 14 dhjetor 1999 Komisioni njohu titullin e ankuesit për dy parcela toke me sipërfaqe 1 100 $m^2$ dhe 537 $m^2$ secila. Komisioni vendosi se ishte e pamundur që ankuesve t'u kompensohej e gjithë sipërfaqja fillestare. Ai vendoi t'u kthejë ankuesve një truall të lirë me sipërfaqe 1 456 $m^2$, i ndodhur brenda mjediseve të zëna nga ambasada italiane dhe urdhëroi autoritetet të paguanin kompensimin në lidhje me sipërfaqen prej 181 $m^2$. Për më tepër, Komsioni urdhëroi regjistrimin e titullit të ankimuesit në regjistrin e pronave të Tiranës.

12. Ankuesve iu dhanë dhe dy certifikata pronësie nga zyra e regjistrimit: regjistrimi nr. 4373, i datës 1 qershor 1996, dhe regjistrimi nr.420, i datës 28 dhjetor 1999.

13. Në një datë të paspecifikuar në vitin 1996 duke pasur parasysh faktin se, sipas notës verbale të vitit 1991, ambasada italiane kishte titullin vetëm për njërën nga ndërtesat, por jo për sipërfaqen e tokës, ankuesit i kërkuan ambasadës t'u kthente pronën e tyre, të cilën ajo (ambasada) e kishte zaptuar pa titull.

14. Më 27 nëntor 1996 Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, duke pasur parasysh pretendimet e pronësisë nga ankuesit për sipërfaqen ngjitur me ndërtesat e ambasadës, ofroi ndërmjetësim për ambasadën italiane, me synimin e arritjes së marrëveshjeve civile me ankuesit.

15. Më 16 gusht 1997 ambasada italiane në Tiranë, në përgjigje të kërkesës së ankuesve për marrjen e pronës së tyre, i informoi ata se pretendimet e tyre të pronësisë për sipërfaqen e tokës që gjendej brenda mjediseve të tyre duhej të zgjidheshin me autoritetet shqiptare.

16. Më 1 tetor 1997, pas një kërkese nga ankuesit, Ministria Italiane e Punëve të Jashtme i informoi ata se, nëpërmjet një shkëmbimi të një note verbale të vitit 1991, ambasada italiane në Shqipëri kishte pronësi të plotë mbi ndërtesat dhe mbi tokën përreth. Për më tepër, ajo i referoi aplikantët tek autoritetet shqiptare si kompetente për të vendosur për pretendimet për kompensim që mund të ngrinin ankuesit.

**B. Proceset gjyqësore për marrjen dhe kompensimin e pronës**

17. Më 2 maj 1997, pas një padie civile të ngitur nga ankuesit kundër Ministrisë së Punëve të Jashtme, Gjykata e Rrethit të Tiranës (Gjykata e Tiranës) konstatoi se ambasada italiane po zaptonte pronën e ankuesit pa pasur titull dhe, duke mos qenë në gjendje të ndërmerrte veprime kundër një misioni diplomatik, ajo urdhëroi Ministrinë e Punëve të Jashtme të lehtësonte marrjen e pronës nga ankuesit dhe, gjithashtu, t'u paguante atyre dëmshpërblimin prej 21 607,50 dollarësh amerikanë.

18. Më 27 janar 1998 Gjykata e Apelit e Tiranës (Gjykata e Apelit) e rrëzoi vendimin e Gjykatës së Rrethit dhe ia ktheu çështjen për rishqyrtim Gjykatës së Rrethit nga një trup gjykues i ndryshëm nga trupi i parë. Sipas Gjykatës së Apelit, Ministria e Punëve të Jashtme, e cila kishte përfaqësuar shtetin shqiptar në marrëveshjen për transferimin e pronësisë tek ambasada italiane, nuk mund të ishte palë e akuzuar në proces për aq kohë sa Ministria e Financës ishte organi kompetent për përfaqësimin e interesave shtetërore në proceset e brendshme. Ankuesit apeluan kundër vendimit të Gjykatës së Apelit në Gjykatën e Kasacionit të asaj kohe.

19. Më 17 qershor 1998 Gjykata e Kasacionit rrëzoi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe ia ridërgoi çështjen për rishqyrtim kësaj gjykate.

20. Më 29 janar 1999 Gjykata e Apelit, gjatë rishqyrtimit të çështjes, konstatoi se Ministria e Punëve të Jashtme nuk mund të ishte përgjegjëse për këtë gjë dhe caktoi ambasadën italiane, e cila kishte zënë pronën e ankuesit pa titull, si subjektin përgjegjës në lidhje me pronësinë. Ajo rrëzoi vendimin e Gjykatës së Rrethit të datës 2 maj 1997 dhe ia rinisi çështjen për rigjykim së njëjtës gjykatë.

21. Më 20 qershor 2000 Gjykata e Rrethit rrëzoi bazën e apelit të ankuesit, duke i shpallur të paligjshme vendimet e Komisionit të datës 18 mars 1996 dhe 14 dhjetor 1999, pasi ato ishin në kundërshtim me seksionin 4 të aktit të pronësisë.

22. Gjykata e Rrethit u shpreh se sipërfaqja e tokës që pretendohej nga ankuesit, megjithëse nuk kishte ndërtesa mbi të, ishte një pjesë përbërëse e mjediseve të ambasadës italiane. Në këtë mënyrë, Gjykata e Rrethit i deklaroi të pavlefshme vendimet e Komisionit dhe vendosi se ankuesit kishin të drejtën e marrjes së kompensimit për pronat fillestare në njërën prej formave të parashikuara në seksionin 16 të aktit të pronësisë.

23. Më 31 tetor 2001 Gjykata e Apelit rrëzoi vendimin e Gjykatës së Rrethit dhe ia dërgoi çështjen për rishikim një paneli të ndryshëm të Gjykatës së Apelit, në përputhje me nenin 467/a të Kodit të Procedurës Civile, pasi kishte vënë re parregullsi në procedimet e gjykatave më të ulëta.

24. Më 29 tetor 2002 Gjykata e Apelit, pasi kishte njoftuar siç duhet për seancën palët kundërshtare, përkatësisht, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Komisionin e Tiranës, Ministrinë e Financës dhe ambasadën italiane në Tiranë, deklaroi të pavlefshme vendimet e Komisionit të datës 18 mars 1996 dhe të datës 14 dhjetor 1999. Ajo vendosi se të gjithë ankuesit kishin të drejtën e marrjes së kompensimit *in lieu* të pronës fillestare në njërën ndër format e parashikura nga ligji përsa i përket sipërfaqës së tokës prej 1 456 $m^2$. Si rrjedhojë, të gjithë ankuesit do të merrnin kompensim në përputhje me aktin e pronësisë për sipërfaqen e përgjithshme prej 1 637 $m^2$. Për më tepër, Gjykata e Apelit u shpreh se, përderisa prona ishte pjesë integrale e ambienteve të ambasadës italiane, ajo nuk mund të konsiderohej si tokë bosh sipas kuptimit të seksionit 4 të aktit të pronësisë (shih paragrafin 31 më poshtë).

25. Më 15 qershor 2004 Gjykata e Lartë, e cila kishte zëvendësuar Gjykatën e Kasacionit, pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Shqipërisë më 28 nëntor 1998, pas një ankimimi të ankuesve, pranoi arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Apelit të datës 29 tetor 2002.

26. Në një datë të paspecifikuar në vitin 2004, ankuesit depozituan një ankesë në Gjykatën Kushtetuese, sipas nenit 131 (f) të Kushtetutës, ku pretendonin se vendimi i Gjykatës së Apelit të Tiranës, i datës 29 tetor 2002 dhe vendimi i Gjykatës së Lartë, i datës 15 qershor 2004, ishin jokushtetuese.

27. Apelimi u shpall i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese më 13 janar 2005 nga një panel prej tre gjyqtarësh. Gjykata u shpreh se ankesa kushtetuese e ankuesve lidhej me vlerësimin e provave, gjë e cila ishte në juridiksionin e gjykatave më të ulëta, por ishte jashtë jurdiksionit të saj.

II. LEGJISLACIONI PËRKATËS NDËRKOMBËTAR DHE I BRENDSHËM

**A. E drejta përkatëse ndërkombëtare**

28. Dispozitat ndërkombëtare përkatëse janë parashtruar në çështjen Treska kundër Shqipërisë dhe Italisë (dec.), nr.26937/04, ECHR 2006-… (fragmente) dhe Manoilescu dhe Dobrescu kundër Rumanisë dhe Rusisë (dec.), nr. 60861/00, §§ 38-39, ECHR 2005-VI.

**B. E drejta përkatëse e brendshme**

1. Kushtetuta

29. Dispozitat përkatëse të Kushtetutës së Shqipërisë parashikojnë si më poshtë:

"Neni 41

1. E drejta e pronës private është e garantuar.

2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.

3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publike.

4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që janë të barazvlefshme me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.

5. Për mosmarrëveshjet lidhur me masën ose shkallën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë."

Neni 42 § 2

"Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj."

Neni 142 § 3

"Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore."

Neni 131

"Gjykata Kushtetuese vendos për: …

(f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shterruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave."

Neni 181

"1. Kuvendi, brenda dy deri tre vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetute nxjerr ligje për rregullimin e drejtë të çështjeve të ndryshme që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit të kësaj Kushtetute, duke u udhëhequr nga kriteret e nenit 41.

2. Ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute dhe që kanë të bëjnë me shpronësimet dhe konfiskimet, do të zbatohen kur nuk vijnë në kundërshtim me të."

2. Akti për kthimin dhe kompensimin e pronës (ligji nr.7698 i datës 15 prill 1993, i ndryshuar me ligjet nr.7736 dhe nr.7765 të vitit 1993, ligjet nr.7808 dhe nr.7879 të vitit 1994, ligji nr.7916 i vitit 1995, ligji nr.8084 i vitit 1996 dhe i shfuqizuar nga ligji nr.9235, datë 29 korrik 2004 dhe i ndryshuar së fundmi nga ligji nr.9388 i vitit 2005 dhe ligji nr.9583 i vitit 2006)

30. Seksionet përkatëse të aktit të pronave (për kthimin dhe kompensimin e pronave) janë përshkruar në çështjen Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë (nr.7352/03, §§ 21-29, 22 gusht 2006), Driza kundër Shqipërisë (nr.33771/02, §§ 36-43, ECHR 2007-…) dhe Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë (nr.38222/02, §§ 23-30, 13 nëntor 2007).

31. Seksioni 4 i aktit të pronës, i vitit 1993, i ndryshuar dhe siç ka qenë në fuqi në kohën fizike, parashikonte se trojet e tokës që ishin bosh do t'u jepeshin dhe ktheheshin ish-pronarëve ose trashëgimtarëve të tyre, me përjashtim të rasteve kur parashikohej ndryshe.

3. Kodi i Procedurës Civile

32. Dispozita përkatëse e Kodit të Procedurës Civile parashikon si më poshtë:

"Neni 39

Anëtarë të përfaqësive konsullore dhe diplomatike me seli në Republikën e Shqipërisë nuk janë subjekt i juridiksionit të gjykatave shqiptare, përveç rasteve:

a) kur ata e pranojnë këtë vullnetarisht;

b) në rastet dhe kushtet e parashikuara nga Konventa e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike.

LEGJISLACIONI

I. BASHKIMI I APLIKIMEVE

33. Duke qenë se të dyja aplikimet kanë të bëjnë me të njëjtat fakte, ankesa dhe procese të gjykatave të brendshme, Gjykata vendos t'i bashkojë ato, sipas nenit 42 § 1 të rregullores së Gjykatës.

II. PRANUESHMËRIA

**A. Përputhshmëria *ratione personae***

34. Ankuesit u ankuan kundër Italisë për shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës, duke qenë se zotërimi *sine titulo* nga ambasada italiane në Tiranë i pronës që u ishte dhënë atyre nga akti i pronësisë, përbënte ndërhyrje për gëzimin e pronave të tyre në paqe.

35. Gjykata duhet të përcaktojë nëse faktet e ngritura nga ankuesi janë të tilla saqë

përfshijnë përgjegjësinë e Italisë sipas Konventës. Siç është theksuar në mënyrë të vazhdueshme prej saj, përgjegjësia e një shteti përfshihet nëse cenohet një ndër të drejtat dhe liritë e përcaktura në Konventë, që vjen si rezultat i shkeljes së nenit 1, nëpërmjet të cilit "Palët e Larta Kontraktuese i sigurojnë çdonjërit në juridiksionin e tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në seksionin I të Konventës" (shih Costello-Roberts kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 25 mars 1993, seritë A nr. 247-C, fq. 57, §§ 25-26).

36. Si rezultat, Gjykata përcakton nëse ankuesit ishin "brenda juridiksionit" të Italisë në kuptimin e kësaj dispozite. Me fjalë të tjera, duhet të përcaktohet nëse, pavarësisht nga fakti që proceset në fjalë nuk janë zhvilluar në territorin e atij shteti, Italia prapë mund të jetë përgjegjëse për rezultatet mbi ta dhe për pamundësinë e pretenduar për zbatimin e vendimeve të autoriteteve shqiptare në favor të ankuesve.

37. Gjykata i referohet jurisprudencës së saj përsa i përket ushtrimit të juridiksionit territorial dhe jashtëterritorial nga një shtet kontraktues (shih, për shembull, Drozd dhe Janousek kundër Francës dhe Spanjës, vendimi i datës 26 qershor 1992, seritë A nr. 240; Banković dhe të tjerët kundër Belgjikës dhe 16 shteteve të tjera kontraktuese (dec.) [GC], nr.52207/99, ECHR 2001-XII; Ilaşcu dhe të tjerët kundër Moldavisë dhe Rusisë [GC], nr.48787/99, ECHR 2004-VII; McElhinney kundër Irlandës dhe Mbretërisë së Bashkuar (dec.) [GC], nr.31253/96, 9 shkurt 2000).

38. Proceset në fjalë janë zhvilluar ekskluzivisht në territorin e Shqipërisë. Gjykatat shqiptare kanë autoritet sovran në çështjen e ankuesve dhe autoritetet italiane nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi vendimet apo gjykimet e dhëna në Shqipëri. Detyrimi për zbatimin e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 15 qershor 2004, e cila vendosi përfundimisht për dëmshpërblim në lidhje me ankuesit, u përket autoriteteve shqiptare.

39. Është e qartë nga rrethanat e çështjes në fjalë se ankuesit nuk ishin në juridiksionin e Italisë. Ky shtet nuk ka ushtruar juridiksion mbi ankuesit. Nuk ka faktor që justifikon sjelljen e aplikimeve nën juridiksionin e Italisë për qëllimet e nenit 1 të Konventës (shih Treska, cituar më lart; Manoilescu dhe Dobrescu, cituar më lart, §§ 104–105).

40. Pra, rezulton se kjo ankesë nuk është në përputhje *ratione personae* me dispozitat e Konventës në kuptim të nenit 35 § 3 dhe duhet të hidhet poshtë në përputhje me nenin 35 § 4.

**B. Përputhshmëria me rregullin e gjashtëmujorit**

41. Më 6 qershor 2006 ankuesi i aplikimit nr.35720/04 depozitoi një ankesë të re në Gjykatë për mungesë arsyetimi në vendimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 13 janar 2005.

42. Gjykata thekson se, në lidhje me ankesat që nuk janë përfshirë në aplikimin fillestar, shtrirja e afatit kohor gjashtëmujor nuk ndërpritet deri në datën kur ankesa i është dërguar për herë të parë një organi të Konventës (shih Allan kundër Mbretërisë së Bashkuar (dec.), nr. 48539/99, vendim i datës 28 gusht 2001).

43. Rezulton se ankesa, për mungesë arsyesh, u paraqit më shumë se gjashtë muaj nga data e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të 13 janarit 2005 dhe si e tillë nuk duhet të pranohet, në përputhje me nenin 35 35 §§ 1 dhe 4.

**C. Çështje të tjera**

44. Ankuesit u ankuan për mohim aksesi në gjykatë përsa i përket papaftësisë së tyre për të hapur një çështje kundër një misioni diplomatik, përkatësisht ambasadës së Republikës së Italisë në Shqipëri.

45. Neni 6 § 1 i siguron gjithsecilit të drejtën për të çuar përpara gjykatës çdo çështje lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tij civile (shih Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 21 shkurt 1975, seritë A nr. 18, § 36). Gjithësesi, e drejta për akses në një gjykatë nuk është absolute, por mund të jetë subjekt i kufizimeve; këto kufizime lejohen nëpërmjet nënkuptimit, pasi e drejta për akses, nga natyra, kërkon rregullim nga shteti (shih Ashingdane kundër Britanisë së Bashkuar, vendim i datës 28 maj 1985, Seritë A nr. 93, § 57).

46. Gjykata thekson se rregullat e njohura gjerësisht të së drejtës ndërkombëtare për imunitetin shtetëror nuk mund të konsiderohen si vendosëse të kufizimeve jopërpjestimore mbi të drejtën e aksesit në një gjykatë, siç parashikohet në nenin 6 § 1 të Konventës. Për shkak se e drejta e aksesit në një gjykatë është pjesë përbërëse e garancisë për një proces të rregullt ligjor në atë nen, po kështu, disa kufizime mbi aksesin duhet të konsiderohen si të qenësishme, si për shembull ato

kufizime që përgjithësisht pranohen nga komuniteti i shteteve si pjesë e doktrinës së imunitetit shtetëror (shih McElhinney kundër Irlandës [GC], nr. 31253/96, § 37, ECHR 2001-XI; Manoilescu dhe Dobrescu, (dec.), cituar më lart, § 80, ECHR 2005-VI; dhe, Treska, cituar më lart).

47. Në çështjen në fjalë nuk ka asgjë që të tregojë shmangie nga këto përfundime. Në këto rrethana, faktet e ankimuara nuk përbëjnë një kufizim të pajustifikuar të së drejtës së ankuesve për të pasur akses në gjykatë. Si rezultat, ankesa nuk është e pranueshme, pasi është haptazi e pabazuar dhe duhet të rrëzohet sipas nenit 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

III. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

48. Ankuesit pretendojnë se ka pasur shumë shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, kryesisht përsa i përket tejzgjatjes së proceseve të brendshme dhe moszbatimit të vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 15 qershor 2004.

Neni 6 i Konventës, në pjesën që lidhet me këtë ankesë, parashikon si më poshtë:

"Në përcaktim të të drejtave të tij civile dhe detyrimeve …, çdokush ka të drejtë të ketë një proces … të drejtë … nga [një] … gjykatë …"

**A. Moszbatimi i vendimit të Gjykatës së Lartë i datës 15 qershor 2004**

1. Pranueshmëria

49. Ankuesit u ankuan për moszbatimin në praktikë nga autoritetet të vendimit të Gjykatës së Lartë që urdhëronte pagimin e kompensimit për ta në lidhje me tokën e paraardhësit të tyre.

50. Qeveria u shpreh se ankuesit nuk kishin shterruar mjetet e reja juridike në vend, të prezantuara nga akti i pronësisë i vitit 2004, në lidhje me këtë ankesë.

51. Gjykata thekson parimin e deklaruar në çështjen Driza (cituar më lart, § 57) dhe është e mendimit se çështja e efektivitetit të mjeteve juridike të ofruara nga aktet e pronësisë është thelbësore për themelin e ankimit të ankuesve, sipas nenit 13 në lidhje me nenin 1 të protokollit nr. 1. Ajo vendos se të dyja çështjet duhet të shqyrtohen në themel së bashku. Për më tepër, kjo ankesë nuk është haptazi e pabazuar në kuptimin e nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo deklaron se nuk ekzistojnë baza të tjera për deklarimin e kësaj ankese të papranueshme dhe, si rezultat, e deklaron atë të pranueshme.

2. Themeli

**(a) Parashtrimet palëve**

52. Qeveria përsëriti se autoritetet nuk mund të jenë përgjegjëse për moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 15 qershor 2004, pasi ekzekutimi varej nga marrja e hapave të nevojshëm nga ankuesit, që do të thotë nga hapja e një çështjeje për të kërkuar zbatimin e saj. Qeveria iu referua argumenteve të saj të mëparshme për shterrimin e mjeteve juridike të brendshme.

53. Ankuesit e kundërshtuan argumentin e qeverisë.

**(b) Vlerësimi i Gjykatës**

54. E drejta për akses në gjykatë, e garantuar nga neni 6 § 1 i Konventës, do të ishte iluzionare nëse sistemi i brendshëm ligjor i shtetit kontraktues lejon që një vendim gjyqësor detyrues i formës së prerë të mbetet i pazbatuar në dëm të njërës prej palëve. Ekzekutimi i një gjykimi të dhënë nga çdo gjykatë, si rezultat, duhet të konsiderohet si një pjesë përbërëse e "procesit", për qëllimet e nenit 6 (shih, *inter alia*, Beshiri dhe të tjerë, cituar më lart, § 60).

55. Konventa nuk mund të interpretohet se vendos detyrime të përgjithshme të shteteve kontraktuese për të marrë prona që u janë transferuar atyre para ratifikimit të Konventës (shih Kopecký k. Sllovakisë [GC], nr. 44912/98, § 35, dhe von Maltzan dhe të tjerë kundër Gjermanisë (dec.) [GC], nr. 71916/01, 71917/01 dhe 10260/02, § 74, ECHR 2005-V). Në Konventë nuk ka ndonjë detyrim për përcaktimin e procedurave ligjore, sipas të cilave mund të kërkohet kthimi i pronësisë. Gjithsesi, kur një shtet kontraktues vendos të përcaktojë procedura të tilla ligjore, ai nuk mund të përjashtohet nga detyrimi për të respektuar të gjitha garancitë përkatëse të parashikuara nga Konventa, në veçanti nga neni 6 § 1.

56. Gjykata rikujton gjetjen e saj në paragrafin 38 më lart. Vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 15 qershor 2004 mund të interpretohet si urdhërues për autoritetet për t'i ofruar ankuesit një formë kompensimi, që do t'i zhdëmtonte ata në vend të kthimit të pronës së tyre fillestare.

57. Gjykata vë re se, pas dhënies së vendimit në vitin 2004, autoritetet nuk iu ofruan ankuesve opsionin e marrjes së kompensimit të duhur (krahasoni Užkurėlienė dhe të tjerët kundër.

Lituanisë, nr. 62988/00, § 36, 7 prill 2005). Në këtë mënyrë, ankuesit nuk kishin as mundësinë e shqyrtimit të një oferte kompensimi *in lieu* të kthimit të pronësisë që më parë u ishte dhënë atyre (shih Driza, cituar më lart, § 90.).

58. Për më tepër, Qeveria nuk ka ofruar asnjë shpjegim në lidhje me arsyen pse vendimi i datës 15 qershor 2004 nuk është zbatuar pas më shumë se pesë vitesh nga dhënia e tij. Nuk duket se autoritetet administrative kanë marrë ndonjë masë për zbatimin e vendimit.

59. Si rezultat, Gjykata është e mendimit se problemi vijon dhe mbetet i pazgjidhur, parësisht nga treguesit që ka dhënë në çështjen Beshiri dhe të tjerët se "në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që urdhërojnë shtetin për kryerjen e një pagese, personit, i cili ka marrë vendimin kundër shtetit për të përftuar pagesën nga ai, nuk duhet t'i kërkohet ndërmarrja e procedimeve për ekzekutim, në mënyrë që të përfitojë shumën e duhur" (shih § 108).

60. Konsideratat e lartpërmendura janë të mjaftueshme për ta bërë Gjykatën në gjendje të arrijë në përfundimin se, duke dështuar në marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e vendimit të datës 15 qershor 2004, autoritetet shqiptare privuan dispozitat e nenit 6 § 1 të Konventës nga të gjitha efektet e dobishme.

61. Kjo, si rezultat, çon në shkeljen e nenit 6 § 1 të Konventës në këtë aspekt.

**B. Zgjatja e procesit**

1. Pranueshmëria

62. Gjykata është e mendimit se ankesa në këtë seksion nuk është haptazi e pabazuar sipas kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo konstaton më tej se nuk ka arsye të tjera për ta deklaruar këtë pjesë të ankesës si të papranueshme dhe, si rezultat, e deklaron atë të pranueshme.

2. Themeli

**(a) Parashtrimet e palëve**

63. Ankuesit u ankuan për zgjatjen e paarsyeshme të proceseve të brendshme, të cilat kishin zgjatur për rreth tetë vjet për nëntë nivele juridiksioni. Ata ua atribuan këtë vonesë autoriteteve të brendshme, të cilat kishin nxjerrë përfundime të ndryshme në nivele të ndryshme juridiksioni, si dhe pozicionit të mbajtur nga Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë në lidhje me të drejtën e tyre të pronësisë.

64. Qeveria parashtroi se proceset kishin qenë komplekse, si rezultat i ndryshimeve dhe vlerësimit të të drejtave të pronësisë në periudha të ndryshme dhe për shkak të faktit se ishte, i përfshirë një mision diplomatik i akreditуar në Shqipëri. Ata shtuan se kompleksiteti i fakteve i kombinuar me mungesën e jurisprudencës kishte çuar në rikthime të shumta të çështjes për rishqyrtim. Ata pretenduan se kohëzgjatja e proceseve nuk kishte ndikim të drejtpërdrejtë mbi të drejtën e ankuesve, pasi ata nuk e kishin zotëruar asnjëherë efektivisht pronën e tyre.

**(b) Vlerësimi i Gjykatës**

65. Gjykata vë re se të gjitha proceset në fjalë lidhen me çështjen e të drejtave të pronësisë së ankuesve. Koha që duhet të merret parasysh, duhet të mbulojë të gjithë kohëzgjatjen e proceseve, të cilat filluan në një datë të paspecifikuar në vitin 1997 dhe përfunduan me vendimin e Gjykatës të datës 13 janar 2005. Për më tepër, vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 15 qershor 2004 nuk është zbatuar ende. Deri më sot, proceset gjyqësore kanë zgjatur për më shumë se njëmbëdhjetë vjet.

66. Gjithsesi, Gjykata është e mendimit se në dritën e gjetjeve të saj për cenim të nenit 6 § 1 të Konventës për moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 15 qershor 2004, asaj nuk i duhet të marrë vendim të veçantë për themelin e ankesës së kohëzgjatjes së gjykimit (shih Lizanets kundër Ukrainës, nr. 6725/03, § 48, 31 maj 2007).

IV. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR.1 TË KONVENTËS

67. Ankuesit u ankuan se paaftësia për t'u dhënë atyre kompensim, sipas vendimit përfundimtar të datës 15 qershor 2004, përbën shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

"Çdo person fizik ose juridik ka të drejtë për të gëzojë në paqe pasuritë e tij. Askush nuk do të privohet nga prona e tij, veçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve të fusin në fuqi ligje që ato i

quajnë të domosdoshme për të rregulluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagesën e taksave, ose të kontributeve të tjera, ose të gjobave."

**A. Pranueshmëria**

68. Gjykata është e mendimit se kjo ankesë nuk është haptazi e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Për më tepër, ajo nuk gjen arsye të tjera për deklarimin e saj të papranueshme dhe, për rrjedhojë, e deklaron atë të pranueshme.

**B. Themeli**

1. Parashtrimet e palëve

69. Qeveria parashtroi se e drejta e ankuesve për pronë nuk është cenuar pasi vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 15 qershor 2004 kishte pranuar të drejtën e tyre për kompensim në njërën ndër format e këtij ligji. Ajo kontestoi se ankuesit ende nuk kishin përmbushur rregullat e parashikuara në aktin e pronësisë, në mënyrë që të përcaktonin formën e atij kompensimi. Ajo shtoi se procesi i kompensimit ishte penguar nga kohëzgjatja e tepruar, e cila ka qenë gjithashtu rezultat i rrethanave objektive, të tilla si mungesa e fondeve dhe interesat e përgjithshme të komunitetit.

70. Ankuesit ishin të mendimit se u ishte cenuar e drejta e tyre për pronësi.

2. Vlerësimi i Gjykatës

71. Gjykata thekson parimet e përcaktuara nga jurisprudenca e saj sipas nenit 1 të protokollit nr.1 (shih, ndërmjet të tjerash, Kopecký kundër Sllovakisë [GC], nr.44912/98, § 35; von Maltzan dhe të tjerë kundër Gjermanisë (ven.) [GC], nr. 71916/01, 71917/01 dhe 10260/02, § 74, ECHR 2005-V; dhe Beshiri dhe të tjerë, të cituar më lart).

72. "Pronat" mund të jenë "prona ekzistuese" ose asete, duke përfshirë, në disa situata të mirëpërcaktuara, dhe pretendimet. Në mënyrë që një pretendim të jetë i aftë të konsiderohet "aset" që bie nën objektin e nenit 1 të protokollit nr.1, ankuesi duhet të sigurohet se ai ka bazë të mjaftueshme në të drejtën e brendshme, ku ka, për shembull, një jurisprudencë të përcaktuar të gjykatave kombëtare që e konfirmojnë atë, ose kur ka një vendim përfundimtar të gjykatës në favor të ankuesit. Kur bëhet kjo, mund të futet në lojë koncepti i "pritjeve legjitime" (shih Draon kundër Francës [GC], nr. 1513/03, § 68, 6 tetor 2005, ECHR 2005-IX, dhe Burdov kundër Rusisë, nr.59498/00, § 40, ECHR 2002-III).

73. Gjykata vë re se ankuesve u është njohur e drejta e kompensimit nëpërmjet vendimit përfundimtar të Gjykatës së Lartë të datës 15 qershor 2004 (shih paragrafin 25 më lart). Pra, ankuesit kishin pretendime të zbatueshme që rridhnin nga vendimi në fjalë.

74. Ajo vë re se kjo ankesë është e lidhur me ankesën e shqyrtuar sipas nenit 6 § 1 në lidhje me paaftësinë për të zbatuar një vendim përfundimtar (shihni paragrafët 54–61 më lart).

75. Gjykata është e mendimit se paaftësia e autoriteteve për të zbatuar vendimin e gjykatës të datës 15 qershor 2004 për një kohë të tillë të gjatë çon në ndërhyrjen e të drejtës së aksuesve për gëzim të paqtë të pronave të tyre, brenda kuptimit të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës.

76. Përsa i përket justifikimit të parashtruar nga qeveria në lidhje me këtë ndërhyrje, Gjykata thekson se mungesa e fondeve nuk mund të justifikojë paaftësinë e shtetit për të zbatuar pagimin e një borxhi të përcaktuar në një vendim përfundimtar dhe detyrues (shih Driza, cituar më lart, § 108; Pasteli dhe të tjerë kundër Moldavisë, nr. 9898/02, 9863/02, 6255/02 dhe 10425/02, § 30, 15 qershor 2004; Voytenko k. Ukrainës, nr.18966/02, § 55, 29 qershor 2004; dhe Shmalko kundër Ukrainës, nr.60750/00, § 57, 20 korrik 2004).

77. Si rezultat, ka pasur shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës në këtë aspekt.

## V. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 13 NË LIDHJE ME NENIN 1 TË PROTOKOLLIT NR.1 TË KONVENTËS

78. Ankuesit u ankuan për mungesë të mjeteve ligjore efektive për të përfituar përcaktimin përfundimtar të të drejtave të tyre të pronësisë. Ata u bazuan në nenin 13 të Konventës, në të cilin parashikohet si më poshtë:

"Çdo personi, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura nga kjo Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare dhe kur kjo shkelje është kryer nga persona që veprojnë brenda funksioneve të tyre zyrtare."

**A. Pranueshmëria**

79. Gjykata është e mendimit se kjo ankesë nuk është haptazi e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo vijon më tej se nuk janë përcaktuar baza të tjera për ta deklaruar atë të papranueshme dhe si rezultat, e deklaron atë të pranueshme.

**B. Themeli**

1. Parashtrimet e palëve

80. Ankuesit parashtruan se nuk kishte mjete ligjore efektive me anë të të cilave të pretendohen kompensimin *in lieu* të kthimit të pronës. Ata argumentuan se si rezultat i vëzhgimeve të Qeverisë për mungesë fondesh dhe mungesë disponueshmërie të parcelave bosh të tokës, ata nuk mund të merrnin kompensimin e përvijuar në vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 15 qershor 2004.

81. Qeveria ngriti të njëjtat kundërshtime në lidhje me paaftësinë e pretenduar për përdorimin e mjeteve efektive ligjore (shih paragrafin 52 më lart). Ajo iu referua mjeteve efektive të prezantuara në aktin e pronësisë të vitit 2004, të cilat duhet të konsideroheshin efektive për qëllime të nenit 13.

2. Vlerësimi i gjykatës

82. Gjykata vë re se ankesa e ankuesve në përputhje me nenin 1 të protokollit nr. 1 të Konventës është pa diskutim "e diskutueshme" Ankuesi, si rezultat, kishte të drejtë të përdorimit të mjeteve ligjore efektive brenda kuptimit të nenit 13 të Konventës.

83. Për më tepër, "autoriteti" të cilit i referohet neni 13 jo domosdoshmërisht në të gjitha rastet është autoritet gjyqësor në kuptim strikt. Gjithsesi, kompetencat dhe garancitë procedurale që zotëron një autoritet janë të mjaftueshme për të përcaktuar nëse mjetet para tij kanë qenë efektive (shih Klass dhe të tjerë kundër Gjermanisë, vendimi i datës 6 shtator 1978, seritë A nr.28, f. 30, § 67). Mjeti i kërkuar sipas nenit 13 duhet të jetë "efektiv" në praktikë dhe në ligj, në veçanti në kuptimin që ushtrimi i tij nuk duhet të pengohet në mënyrë të pajustifikueshme nga veprimet ose mosveprimet e autoriteteve të shtetit përkatës (shih Aksoy kundër Turqisë, vendim i datës 18 dhjetor 1996, Reportet 1996-VI, f. 2286, § 95 në gjoba).

84. Gjykata i referohet gjetjeve të saj në çështjen Driza, të cituar më lart, §§ 117-120. Qeveria nuk dha asnjë informacion në lidhje nëse kishte pasur masa të veçanta të miratuara ose veprime të marra që prej dhënies së vendimit për çështjen Driza. Në rastin në fjalë, nuk ka asnjë tregues të largimit nga gjetje të tilla. Pra, rezulton se ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës në lidhje me nenin 1 të protokollit nr.1.

85. Mbi këtë bazë, kundërshtimi paraprak i qeverisë bazuar në mospërdorimin e mjeteve të brendshme juridike duhet të rrëzohet.

VI. ZBATIMI I NENIT 46 DHE 41 TË KONVENTËS

**A. Neni 46 i Konventës**

86. Neni 46 i Konventës parashikon:

"1. Palët e Larta Kontraktuese zotohen t'u binden vendimeve përfundimtare të Gjykatës për çështjet në të cilat ata janë palë.

2. Vendimi përfundimtar i Gjykatës i transmetohet Këshillit të Ministrave, i cili mbikëqyr zbatimin e tij."

87. Gjykata thekson gjetjet e saj në çështjen Driza (të cituar më lart, §§ 122 – 126) në lidhje me nenin 46 të Konventës. Ajo i bën thirrje shtetit të paditur të marrë masa të përgjithshme siç tregohet në paragrafin 126 të vendimit të lartpërmendur.

**B. Neni 41 i Konventës**

88. Neni 41 i Konventës parashikon:

"Kur Gjykata konstaton shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese mundëson vetëm ndreqje të pjesshme të pasojave që kanë rrjedhur nga kjo shkelje, Gjykata, nëse është e nevojshme, i jep palës së dëmtuar një shpërblim të drejtë."

89. Ankuesit pretenduan një total prej 2,719,500 eurosh në lidhje me dëmin material dhe 200,000 euro në lidhje me dëmin jomaterial. Në lidhje me pretendimin për dëm material, ankuesit parashtruan një vlerësim të pronës nga një ekspert, i cili e vlerësoi vlerën e pronës në 2,184,000 euro dhe humbjen e fitimeve në periudhën nga 1996 deri në 2006 në 535,500 euro.

90. Qeveria nuk parashtroi asnjë koment.

91. Gjykata është e mendimit se çështja e aplikimit të nenit 41 nuk është gati për vendim. Si rezultat, çështja duhet të rezervohet dhe duhet të fiksohet një procedurë e mëtejshme, duke i kushtuar rëndësi mundësisë së arritjes së një marrëveshjeje ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe ankuesve të tjerë.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA: UNANIMISHT

1. *Vendos* të bashkojë ankimet.

2. *I deklaron* ankesat e ankuesve të lidhura me nenin 6 § 1 të Konventës, për sa i përket mohimit të aksesit në gjykatë dhe mungesës së arsyetimit në vendimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 13 janar 2005, të papranueshme;

3. *Deklaron* ankimin e ankuesve sipas nenin 1 të protokollit nr.1 të Konventës të papërputhshëm *ratione personae* për sa kohë ai ishte në mënyrë të drejtëpërdrejtë kundër Italisë.

4. *Bashkohet* me themelin e kundërshtimit paraprak të qeverisë në lidhje me mosshterimin e mjeteve të brendshme juridike nga ankuesit dhe deklaron pjesën tjetër të aplikimit të pranueshme.

5. *Vendos* se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 15 qershor 2004.

6. *Vendos* se nuk e konsideron të nevojshme shqyrtimin e ankesës për kohëzgjatjen e proceseve sipas nenit 6 § 1 të Konventës.

7. *Vendos* se ka pasur shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës.

8. *Vendos* se ka pasur shkelje të nenit 13 në lidhje me nenin 1 të protokollit nr.1 të Konventës, dhe si rezultat *rrëzon* kundërshtimet paraprake të qeverisë.

9. *Vendos* se çështja e zbatimit të nenit 41 nuk është e gatshme për vendim; rrjedhimisht:

a) *e rezervon* tërësisht çështjen e sipërpërmendur;

b) *fton* Qeverinë dhe ankuesit të parashtojnë, brenda tre muajve të ardhshëm nga data në të cilën vendimi bëhet përfundimtar sipas parashikimit të nenit 44 § 2 të Konventës, vëzhgimet e tyre me shkrim për çështjen dhe në veçanti, të njoftojnë Gjykatën për marrëveshje që mund të arrihen prej tyre;

c) *rezervon* procedurën mëtejshme dhe i delegon presidentit të trupit gjykues kompetencën e fiksimit të kësaj çështjeje, nëse del e nevojshme.

Përgatitur në anglisht, dhe njoftuar me shkrim më 29 shtator 2009, në përputhje me nenin 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

| | |
|---|---|
| Lawrence Early | Nicolas Bratza |
| Sekretar | President |

SEKSIONI I KATËRT
ÇËSHTJA GJYLI KUNDËR SHQIPËRISË
(Ankimi nr. 32907/07)
VENDIM
(themeli)
STRASBURG
29 shtator 2009

Ky vendim bëhet i formës së prerë në rrethanat e parashikuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund të jetë objekt rishikimi redaktorial.

Në çështjen Gjyli k. Albania,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), me trup gjykues të përbërë prej:

Nicolas Bratza, President,
Lech Garlicki,
Giovanni Bonello,
Ljiljana Mijović,
Päivi Hirvelä,
Ledi Bianku,
Nebojša Vučinić, gjyqtarë,
dhe Lawrence Early, sekretar i seksionit,
pas shqyrtimit me dyer të mbyllura më 8 shtator 2009,
Merr në këtë datë vendimin e mëposhtëm:

PROCEDURA

1. Çështja e ka zanafillën në një ankim (nr.32907/07) kundër Republikës së Shqipërisë dërguar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kryesore të njeriut (Konventa) nga një nënshtetas shqiptar, Z. Ali Gjyli (ankuesi), më 13 korrik 2007.

2. Ankuesi, i cili kishte përfituar ndihmë ligjore, u përfaqësua nga z. S. Puto, avokat, që ushtron profesionin e tij në Tiranë. Qeveria shqiptare ("Qeveria") u përfaqësua nga Agjentja e asaj kohe, Znj. S. Meneri.

3. Ankuesi u ankua për moszbatimin e dy vendimeve të gjykatës.

4. Më 7 nëntor 2007 ankimit iu dha përparësi sipas nenit 41 të rregullores së Gjykatës.

5. Më 12 dhjetor 2007 kryetari i trupit gjykues të cilit i ishte caktuar çështja vendosi ta njoftojë Qeverinë për ankimin. Sipas dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës, u vendos të shqyrtohej themeli i ankimit në të njëjtën kohë me pranueshmërinë e çështjes.

6. Secila nga palët, ankuesi dhe Qeveria parashtruan vëzhgimet e tyre me shkrim (neni 59 § 1).

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

7. Ankuesi ka lindur në vitin 1945 dhe banon në Durrës, Shqipëri.

**A. Proceset në lidhje me heqjen nga puna të ankuesit**

8. Ankuesi ishte i punësuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit (SHKP) si Drejtor i Qendrës së Trajnimit Profesional në Durrës ("SHKP-ja e Durrësit). SHKP-ja është në varësi të Ministrisë së Punës. Më 9 korrik 2005, ankuesi u hoq nga puna. Duke e konsideruar heqjen e tij nga puna arbitrare, ai iu drejtua Gjykatës së Rrethit të Durrësit. Ankuesi nuk kërkoi dëmshpërblim për dëm material.

9. Në vendimin e saj të datës 27 shtator 2005, Gjykata e Rrethit të Durrësit e deklaroi të pavlefshme heqjen nga puna si rezultat i një procedure të parregullt dhe urdhëroi kthimin e tij në punë. Më 1 nëntor 2005, SHKP-ja e apeloi vendimin në Gjykatën e Apelit të Durrësit (Gjykata e Apelit).

10. Me anë të vendimit të datës 12 dhjetor 2005, Gjykata e Apelit të Durrësit e deklaroi ankimin të papranueshëm pasi ai ishte depozituar pas mbarimit të afatit ligjor. Ky gjykim mori formë të prerë pasi për të nuk u depozitua asnjë ankim në Gjykatën e Lartë.

11. Për qëllim të ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit të datës 27 shtator 2005, gjykata lëshon një urdhër ekzekutimi më 22 dhjetor 2005, në përputhje me nenet 510 (a) dhe 511 (a) të Kodit të Procedurës Civile (shih "legjislacionin dhe praktikën e brendshme përkatëse" më poshtë).

12. Më 23 janar 2006 zyra e përmbarimit lëshoi një gjobë për Ministrin e Punës në lidhje me moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit. As sot e kësaj dite vendimi i Gjykatës së Rrethit të Durrësit nuk është ekzekutuar.

**B. Proceset në lidhje me pagimin e pagave të humbura**

13. Në një datë të paspecifikuar, ankuesi depozitoi një ankim në Gjykatën e Rrethit të Durrësit, ku kërkonte pagimin e pagave të humbura që prej 9 korrikut 2005.

14. Më 24 tetor 2006 Gjykata e Rrethit të Durrësit vendosi në favor të ankuesit dhe urdhëroi SHKP-në t'i paguante ankuesit pagën e tij që prej datës 9 korrik 2005 deri në datën e rikthimit të tij në punë.

15. Më 14 qershor 2007, Gjykata e Apelit të Durrës-it e rrëzoi ankimin e bërë nga SHKP-ja. SHKP-ja ankimoi vendimin në Gjykatën e Lartë. Sipas informacionit që i është dhënë Gjykatës, duket se procesi është ende pezull në Gjykatën e Lartë.

16. Më 6 dhjetor 2006, me kërkesë të ankuesit, Gjykata e Rrethit të Durrësit lëshoi një urdhër ekzekutimi për vendimin e saj të datës 24 tetor 2006.

17. Në një datë të paspecifikuar, SHKP-ja kërkoi pezullimin e menjëhershëm të ekzekutimit. Gjykata e Rrethit të Durrësit vendosi që çështja dilte jashtë juridiksionit të saj territorial dhe ia transferoi atë Gjykatës së Rrethit të Tiranës.

18. Më 31 janar 2008 Gjykata e Rrethit të Tiranës rrëzoi padinë e SHKP-së. Në një datë të paspecifikuar, SHKP-ja e ankimoi këtë vendim. Duket sikur çështja është pezull në Gjykatën e Apelit të Tiranës.

II. LEGJISLACIONI DHE PRAKTIKA E BRENDSHME PËRKATËSE

A. Kushtetuta e Shqipërisë

19. Pjesët përkatëse të Kushtetutës së Shqipërisë parashikojnë si më poshtë:

"Neni 42 § 2

Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj."

Neni 131

Gjykata Kushtetuese vendos për: … (f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave."

"Neni 142 § 3

Organet e shtetit janë të detyruara të zbatojnë vendimet gjyqësore."

**B. Akti i Gjykatës Kushtetuese (organizimi dhe funksionimi) (ligji nr.8577) i datës 10 shkurt 2000**

20. Akti i Gjykatës Kushtetuese, në pjesën që lidhet me këtë çështje, parashikon si më poshtë:

"Neni 81 – Ekzekutimi i vendimeve

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë detyruese.

2. Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese sigurohet nga Këshilli i Ministrave nëpërmjet organeve përkatëse të administratës shtetërore.

3. Gjykata Kushtetuese mund të caktojë një tjetër organ përgjegjës për ekzekutimin e vendimeve të tij, dhe, sipas nevojës, dhe metodën e ekzekutimit të tij.

4. Personat që nuk zbatojnë ose parandalojnë zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, kur veprimi i tyre nuk përbën një vepër penale, janë objekt i një gjobe (…) të vënë nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, vendimi i të cilit është përfundimtar dhe përbën një titull ekzekutiv."

**C. Jurisprudenca përkatëse e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë**

1. Vendimi nr.6/06 i datës 31 mars 2006

21. Çështja kishte të bënte me një mosmarrëveshje pune, të ardhur si rezultat i heqjes së ankuesit nga puna. Gjykatat e brendshme vendosën për kthimin në punë të ankuesit dhe urdhëruan pagimin e pagave të tij të munguara. Përderisa përmbaruesit nuk ishin efektivë në zbatimin e vendimit përfundimtar kundër bashkisë, ankuesi iu drejtua në Gjykatën Kushtetuese.

22. Me anë të vendimit nr.6 të datës 31 mars 2006, Gjykata Kushtetuese, duke pasur parasysh vendimin e kësaj Gjykate në çështjen Qufaj Co. sh.p.k. kundër Shqipërisë (nr.54268/00, 18 nëntor 2004), vendosi se kishte shkelje të së drejtës së ankuesit për një proces të rregullt ligjor për shkak të moszbatimit të vendimit përfundimtar të Gjykatës. Gjithsesi, ankuesit nuk iu dha asnjë dëmshpërblim.

2. Vendimi nr. 43/07 i datës 13 nëntor 2007

23. Çështja kishte të bënte me moszbatimin e një vendimi të një gjykate të brendshme për pagimin e pagave të papaguara të ankuesit nga një njësi administrative e qeverisë vendore (këshilli i rrethit).

24. Gjykata Kushtetuese u shpreh se argument i palës së paditur për mungesë fondesh ishte i pamjaftueshëm dhe nuk mund të justifikonte mosplotësimin e detyrimit për ankuesin. Në vendim, në pjesët që lidhen me këtë çështje, thuhet:

"(…) Gjykata Kushtetuese nuk gjen ndonjë shkak të arsyeshëm që justifikon cenimin e së drejtës së ankuesit për një proces të drejtë ligjor, të shkaktuar nga moszbatimi nga autoritetet përkatëse të vendimit përfundimtar të gjykatës. Ajo është e mendimit se në procesin në fjalë pala debitore ka pasur të gjitha mjetet e disponueshme gjatë të gjithë kohës, që prej datës së marrjes së vendimit e në vijim, për të paguar ankuesin në shumën e përcaktuar në vendimin e gjykatës. Për më tepër, gjatë shqyrtimit të çështjes, Gjykata Kushtetuese nuk mundi të dallonte masa konkrete të palës debitore apo të shihte demonstrim prej saj të vullnetit për të zbatuar vendimin që rridhte nga vendimi i gjykatës.

Për më tepër, në lidhje me organin përgjegjës sipas ligjit për zbatimin e vendimeve të formës së prerë të gjykatave, pra përmbaruesit, Gjykata Kushtetuese shprehet se ata duhet të zbatojnë me korrektësi të gjithë legjislacionin përkatës procedural, pavarësisht nga fakti që pala debitore është institucion shtetëror. Të gjitha palët, qoftë subjekte private ose publike, mbajnë të njëjtën përgjegjësi kur përballen me detyrimin për të zbatuar një vendim të formës së prerë të gjykatës.

Për të përfunduar, duke pasur parasysh arsyetimin e mësipërm, në proceset në fjalë, Gjykata Kushtetuese konstaton se moszbatimi i vendimit përfundimtar (…) të gjykatës përbën shkelje të së drejtës së ankuesit për proces të rregullt ligjor, siç parashikohet në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 § 1 të Konventës."

25. Gjithsesi, ankuesit nuk iu dha asnjë dëmshpërblim.

3. Vendimi nr.1/09 dhe 6/09 i datës 19 janar dhe 6 mars 2009

26. Vendimi nr.1/09 ka të bëjë me moszbatimin e një vendimi përfundimtar administrativ në lidhje me kthimin në punë të ankuesit dhe pagimin e pagave të humbura prej tij. Vendimi nr. 6/09 kishte të bënte me moszbatimin e një vendimi përfundimtar të gjykatës në lidhje me lirimin e një parcele toke.

27. Në të dyja vendimet, Gjykata Kushtetuese deklaroi se kishte pasur shkelje të së drejtës së ankuesit për akses në gjykatë për shkak të moszbatimit të një vendimi përfundimtar administrativ dhe për moszbatim të një vendimi të gjykatës. Gjykata Kushtetuese nuk urdhëroi rikthimin në punë të ankuesit në lidhje me vendimin nr.1/09. Asnjërit nga ankuesve nuk iu dha asnjë dëmshpërblim për dëme material ose jomateriale.

**D. Kodi i Procedurës Civile**

28. Pjesët përkatëse të Kodit të Procedurës Civile parashikojnë si më poshtë:

**"Neni 451 – Vendimi i formës së prerë**

Vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur:

a) nuk mund të bëhet ankim kundër tij;

b) nuk është bërë ankim kundër tij brenda afateve të caktuara nga ligji ose kur ankesa është tërhequr;

c) ankesa e paraqitur nuk është pranuar;

d) vendimi i gjykatës është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë.

**Neni 479 – Pezullimi i ekzekutimit të vendimit**

Gjykata e Lartë pezullon ekzekutimin e vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme;

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit."

**Neni 510 – Titujt ekzekutivë**

Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv.

Janë tituj ekzekutivë:

a) vendimet civile të gjykatës që kanë marrë formë të prerë. …

**Neni 511 – Urdhri i ekzekutimit**

"Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim me kërkesën e kreditorit. Për këtë qëllim lëshohet urdhri i ekzekutimit, i cili jepet:

a) nga gjykata që ka dhënë vendimin në rastet e parashikuara në [nenin 510 (a)];

(…)."

LEGJISLACIONI

I. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

29. Ankuesi u ankua sipas nenit 6 § 1 të Konventës për moszbatim të vendimit të Gjykatës së Durrësit të datës 27 shtator 2005, që urdhëronte kthimin e tij në detyrë dhe të vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit të datës 24 tetor 2006, që urdhëronte pagimin e pagave të munguara për të.

Neni 6 § 1 i Konventës, në pjesët që lidhen me këtë çështje, parashikon si më poshtë:

"Në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile, … çdo person ka të drejtën e një procesi të drejtë ligjor … nga [një] … gjykatë …"

**A. Pranueshmëria**

1. Moszbatimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit të datës 24 tetor 2006 në lidhje me pagimin e pagesave të munguara

30. Qeveria u shpreh se ankuesi nuk kishte shteruar mjetet e brendshme juridike në lidhje me këtë ankim. Deri më sot, procesi është pezull në Gjykatën e Lartë (shih paragrafët 13–15 më lart).

31. Ankuesi pranoi se proceset ishin pezull para Gjykatës së Lartë, por pretendon se vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës ishte i zbatueshëm. Gjykata e Lartë nuk kishte pezulluar zbatimin sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.

32. Në çështjen në fjalë, Gjykata vë re se vendimi i Gjykatës së Rrethit Durrës të datës 24 tetor 2006, i pranuar nga vendimi i Gjykatës së Apelit të Durrësit të datës 14 qershor 2007, njihte të drejtën e ankuesit për pagimin e pagesave të tij të munguara nga 9 korriku 2005 deri në datën e kthimit të tij në punë. Në përputhje me nenet 510(a) dhe 511(a) të Kodit të Procedurës Civile u lëshua një urdhër ekzekutimi. Ndërkohë, pala e paditur apeloi në Gjykatën e Lartë të dyja vendimet e gjykatave më të ulëta (shih paragrafin 15 më lart).

33. Në këto rrethana, Gjykata është e mendimit se vendimi i Gjykatës së Rrethit të Durrësit të datës 24 tetor 2006 nuk mund të konsiderohet përfundimtar dhe detyrues, pasi ai ishte i hapur për ankim. Në fakt, procesi i apelimit është pezull para Gjykatës së Lartë. Edhe nëse një ankesë në Gjykatën e Lartë nuk ka efekt pezullues automatik dhe, pavarësisht nga kompetencat e Gjykatës së Lartë sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Gjykata kujton se neni 6 mbron zbatimin e vendimeve përfundimtare dhe detyruese, dhe jo vendimeve të cilat mund të jenë objekt i kontrollit të mëpasshëm të një gjykate të një niveli më të lartë, dhe, eventualisht, mund të rrëzohen (shih, për shembull, Ouzounis dhe të tjerë kundër Greqisë, nr. 49144/99, § 21, 18 prill 2002; Ioannis Karahalios kundër Greqisë (ven.), nr.62499/00, 26 shtator 2002; Xheraj kundër Shqipërisë, nr.37959/02, § 70, 29 korrik 2008).

34. Duke pasur parasysh proceset pezull në Gjykatën e Lartë, çfarë do të thotë që vendimi i Gjykatës së Rrethit Durrës nuk ka efekt *res judicata*, Gjykata është e mendimit se kjo ankesë nuk është e pranueshme, pasi është e parakohshme dhe duhet të rrëzohet sipas nenit 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

2. Moszbatimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit të datës 27 shtator 2005 në lidhje me kthimin në punë të ankuesit

35. Qeveria kontestoi zbatueshmërinë e nenit 6 § 1, duke u mbështetur në vendimin për çështjen Pellegrin kundër Francës ([GC] nr.28541/95, §§ 66-67, ECHR 1999-VIII). Prej saj u sqarua se mosmarrëveshjet që rrjedhin nga punësimi ndërmjet shtetit dhe nëpunësve të tij civilë, si rregull, nuk konsiderohen si "civile" në kuptimin e nenit 6 § 1 të Konventës.

36. Qeveria parashtroi gjithashtu se Gjykata Kushtetuese ishte një mjet juridik për t'u shteruar në lidhje me moszbatimin e një vendimi përfundimtar të gjykatës. Ata iu referuan vendimit të kësaj Gjykate në çështjen Qufaj Co. sh.p.k. kundër Shqipërisë, (nr.54268/00, § 42, 18 nëntor 2004), siç aplikohet nga Gjykata Kushtetuese (vendimet nr.6/06 dhe 43/07, shih paragrafët 21-27 më lart).

37. Gjykata thekson se neni 6 § 1 nën kokën "civile" të tij është i zbatueshëm për të gjitha mosmarrëveshjet që përfshijnë nëpunësit civilë, në përjashtim të rasteve kur legjislacioni i brendshëm përjashton shprehimisht aksesin në një gjykatë për postin ose kategorinë e stafit/personit në fjalë, dhe kur ky përjashtim është i justifikuar me arsye objektive në interes të shtetit. Në parim nuk mund të ketë justifikim për përjashtim nga garancitë e nenit 6 të mosmarrëveshjeve të zakonshme të punës, të tilla si mosmarrëveshje që lidhen me pagat, dietat apo çështje të tilla të ngjashme, mbi bazën e natyrës së posaçme të marrëdhënies ndërmjet nëpunësit civil të veçantë dhe shtetit në fjalë (shih Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës, nr.43803/98, § 62, 8 gusht 2006).

38. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, Gjykata vë re se pretendimi civil i ankuesit u shqyrtua dhe u zgjidh nga gjykatat e brendshme sipas rregullave të zakonshme të procedurës civile. Ankuesi nuk u përjashtua nga legjislacioni i brendshëm nga "aksesi në gjykatë" brenda kuptimit të nenit 6 të Konventës. Bazuar në testin e zhvilluar në çështjen Eskelinen dhe të tjerë, cituar më lart, Gjykata arrin në përfundimin se neni 6 është i zbatueshëm në proceset e brendshme në fjalë.

39. Gjykata është e mendimit se çështja e shterimit të mjeteve të brendshme ligjore është e lidhur ngushtë dhe thelbësore për çështjen e efektivitetit të ankesës kushtetuese në lidhje me moszbatimin e një vendimi përfundimtar gjykate, i cili është shqyrtuar sipas nenit 13 më poshtë (shih paragrafët 48-61 më poshtë).

40. Ajo konstaton se ky ankim nuk është haptazi i pabazuar në kuptimin e nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo konstaton më tej se kërkesa nuk është e papranueshme për arsye të tjera. Si rezultat, ajo duhet deklaruar e pranueshme.

**B. Themeli**

1. Parashtrimet e palëve

41. Qeveria parashtroi se emërimi i ankuesit si Drejtor i Qendrës së Trajnimit Profesional në Durrës kishte qenë i paligjshëm. Si rezultat, ai ishte hequr nga puna.

42. Ankuesi deklaroi se vendimi i Gjykatës së Rrethit të Durrësit të datës 27 shtator 2005, i cili ishte bërë vendim i formës së prerë më datë 14 janar 2006, nuk ishte zbatuar, duke përbërë kështu shkelje të nenit 6 të Konventës. Përpjekjet e ndërmarra nga përmbaruesi kishin qenë të pamjaftueshme dhe jo efektive.

2. Vlerësimi i Gjykatës

43. Gjykata thekson se një vonesë e tejzgjatur e paarsyeshme në zbatimin e një vendimi përfundimtar dhe detyrues mund të shkelë Konventën (shih Burdov kundër Rusisë, nr.59498/00, ECHR 2002-III). Arsyeshmëria e një vonese të tillë duhet përcaktuar duke pasur parasysh në veçanti kompleksitetin e zbatimit të proceseve, sjelljen e vetë ankuesit dhe të organeve kompetente dhe masën dhe natyrën e dëmshpërblimit të përcaktuar nga gjykata (shih Raylyan kundër Rusisë, nr. 22000/03, § 31, 15 shkurt 2007).

44. Një person që ka marrë një vendim kundër shtetit mund të mos pritet të kërkojë një proces të posaçëm për zbatimin (shih Metaxas kundër Greqisë, nr. 8415/02, § 19, 27 maj 2004). Në raste të tilla, autoriteti i shtetit të paditur duhet njoftuar në kohë për vendimin dhe në këtë mënyrë të jetë i mirëpozicionuar për ta përmbushur vendimin ose për t'ia transferuar atë një tjetër autoriteti shtetëror që është përgjegjës për ekzekutimin.

45. Gjykata vë re se Qeveria nuk parashtroi ndonjë arsye bindëse për moszbatimin nga autoritetet përgjegjëse të vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit të datës 27 shtator 2005. Në lidhje me sugjerimin e Qeverisë se emërimi i ankuesit ishte i padrejtë, gjykatat e brendshme vendosën në favor të tij. Rreziku i çdo gabimi duhet t'i ngarkohet shtetit dhe ato (gabimet) nuk duhet të ndreqen në kurriz të individit përkatës (shih Xheraj, cituar më lart, § 58).

46. Autoritetet kombëtare duket se nuk kanë bërë përpjekje për t'i ofruar ankuesit një zgjidhje alternative, për shembull për t'i dhënë atij një tjetër pozicion të të njëjtit nivel. Nuk ka informacion për të dëshmuar se zbatimi përfshinte ndonjë kompleksitet specifik. Ankuesi nuk e pengoi zbatimin. Gjykata nuk gjen justifikim për këtë periudhë moszbatimi, e cila vijon dhe sot e kësaj dite dhe ka cenuar thelbin e të drejtës së ankuesit për një proces të rregullt në gjykatë.

47. Për arsyet e lartpërmenduara, Gjykata është e mendimit se ka shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

II. SHKELJE E NENIT 13 NË LIDHJE ME NENIN 6 § 1 TË KONVENTËS

48. Ankuesi nuk u ankua për mungesë të mjeteve ligjore të brendshme efektive në lidhje me moszbatimin e vendimeve në favor të tij.

49. Gjithsesi, Gjykata vë re se mungesa e efektivitetit të masave të brendshme ligjore po rritet gjithnjë e më tepër përpara kësaj Gjykate në çështjet që lidhen me moszbatimin ose zbatimin e vonuar të vendimeve të brendshme të formës së prerë. Si rezultat, Gjykata ka vendosur me mocion të saj të shqyrtojë këtë çështje sipas nenit 13 të Konventës (shih, për shembull, Burdov kundër Rusisë (nr.2), nr.33509/04, §§ 89-117, 15 janar 2009; Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë, nr. 7352/03, 22 gusht 2006; dhe Qufaj Co. sh.p.k. kundër Shqipërisë, nr.54268/00, 18 nëntor 2004).

Neni 13 i Konventës thotë:

"Çdo personi, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura nga kjo Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare dhe kur kjo shkelje është kryer nga persona që veprojnë brenda funksioneve të tyre zyrtare."

**A. Pranueshmëria**

50. Gjykata është e mendimit se kjo ankesë nuk është haptazi e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo konstaton se kërkesa nuk është e papranueshme për shkak të ndonjë baze tjetër. Si rezultat, Gjykata e deklaron atë të pranueshme.

**B. Themeli**

1. Parashtrimet e palëve

51. Qeveria u shpreh se një ankim kushtetues është mjet efektiv ligjor në kuadrin e vendimit të Gjykatës në çështjen Qufaj Co. sh.p.k., të cituar më lart dhe në jurisprudencën e Gjykatës (shih paragrafët 21-27 më lart).

52. Ankuesi u shpreh se një ankim kushtetues rreth moszbatimit të një vendimi përfundimtar të gjykatës nuk është masë efektive, siç kërkohet në nenin 13 të Konventës. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese (shih paragrafët 21-27 më lart) u kufizuan në gjetjen e një shkeljeje të një natyre deklarative. Ata nuk parashikonin një mjet efektiv ligjor apo nuk e eliminuan vijimësinë e

shkeljes përsa i përket moszbatimit të një vendimi përfundimtar të gjykatës.

2. Vlerësimi i Gjykatës

**A. Parimet e përgjithshme**

53. Neni 13 i Konventës garanton disponueshmërinë në nivelin kombëtar të një mjeti ligjor për të zbatuar thelbin e të drejtave dhe lirive të Konventës në çdo lloj forme që mund të jetë parashikuar në rendin e tyre të brendshëm ligjor. Efekti i nenit 13 në këtë mënyrë kërkon ofrimin e mjeteve të brendshme juridike për të trajtuar përmbajtjen e një "ankese të diskutueshme" sipas Konventës dhe për të dhënë kompensimin e duhur (shih Kudła kundër Polonisë [GC], nr. 30210/96, § 157, ECHR 2000-XI).

54. Objekti i detyrimeve të shteteve kontraktuese sipas nenit 13 ndryshon në varësit të natyrës së ankimit të ankuesit; gjithsesi, mjeti juridik i nenit 13 ndryshon në varësi të natyrës së ankimit të ankuesit; gjithsesi, mjeti juridik i kërkuar nga neni 13 duhet të jetë "efektiv" si në praktikë, dhe në ligj (shih, për shembull, İlhan kundër Turqisë [GC], nr. 22277/93, § 97, ECHR 2000-VII) në kuptimin ose të parandalimit të shkeljes së pretenduar ose të vijimësisë së saj, ose të ofrimit të kompensimit të përshtatshëm për çdo shkelje të ndodhur (shih Kudla, cituar më lart, § 158).

**B. Ankimi në çështjen në fjalë**

55. Gjykata vë re se në sistemin ligjor shqiptar çdokush që mendon se i janë shkelur të drejtat e tij për një proces të rregullt ligjor, mund, nëse ka shteruar të gjitha mjetet e brendshme juridike, të depozitojë një ankim kushtetues në Gjykatën Kushtetuese sipas nenit 131 (f) të Kushtetutës.

56. Në vendimin e saj për çështjen Qufaj Co. sh.p.k. (cituar më lart, § 42), Gjykata konstatoi se:

"Gjykata Kushtetuese ishte kompetente për të trajtuar ankimin e shoqërisë tregtare të ankuesit në lidhje me moszbatimin e një vendimi përfundimtar si pjesë e juridiksionit të saj për të siguruar të drejtën e një gjykimi të drejtë".

Ky element i së drejtës për një proces të drejtë ligjor u reflektua për herë të parë në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.6/06 dhe më pas u pranua dhe në vendimet e saj nr.43/07, 1/09 dhe 6/09.

57. Në çështjen në fjalë, gjithsesi, Gjykata vë re se ankuesi nuk depozitoi një ankim kushtetues në Gjykatën Kushtetuese në lidhje me moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit të datës 27 dhjetor 2005. Gjykata duhet të përcaktojë nëse mjetet ligjore të sipërpërmendura kanë qenë "efektive" në kuptimin ose të parandalimit të shkeljes së pretenduar ose të vijimësisë së saj, ose të ofrimit të dëmshpërblimit të përshtatshëm për çdo shkelje të ndodhur.

58. Gjykata vë re se vendimet e Gjykatës Kushtetuese (shih paragrafët 21-27 më lart) njohën se ka një shkelje të së drejtës së ankuesit për akses në gjykatë lidhur me moszbatimin e vendimeve të gjykatave së brendshme. Gjithsesi, gjetjet e tyre ishin deklaruese në kuptimin që Gjykata Kushtetuese nuk ofroi ndonjë dëmshpërblim efektiv. Më specifikisht, ajo nuk dha ndonjë dëmshpërblim për dëme materiale e jo-materiale, dhe as që mundi të ofrojë një perspektivë të qartë për të parandaluar një shkelje të pretenduar ose vijimësinë e saj.

59. Për më tepër, Gjykata vë re se veprimet e përmbaruesit nuk ishin efektive në rastin në fjalë. Plus, Qeveria nuk konsideroi praninë e ndonjë mase alternative parandaluese, e cila, në rrethanat e kësaj çështjeje, do t'i ishte ofruar ankuesit.

60. Gjykata arrin në përfundimin se, si rrjedhim, ka shkelje të nenit 13 në lidhje me nenit 6 § 1 të Konventës.

61. Mbi këtë bazë, kundërshtimi paraprak i Qeverisë, bazuar në mosshterimin e mjeteve të brendshme juridike, duhet të rrëzohet.

III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

62. Neni 41 i Konventës parashikon:

"Kur Gjykata konstaton shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese mundëson vetëm ndreqje të pjesshme të pasojave që kanë

rrjedhur nga kjo shkelje, Gjykata, nëse është e nevojshme, i jep palës së dëmtuar një shpërblim të drejtë"

**A. Dëmi material**

63. Ankuesi pretendoi 2,724,965 lekë (rreth 22,272 euro) në lidhje të dëmit material. Ai parashtroi shumën për pagën e munguar nga 9 korriku i 2005-ës deri më 31maji i 2008-ës, duke pasur parasysh vendimin e Gjykatës së Rrethit të Durrësit të datës 24 tetor 2006.

64. Qeveria parashtroi se procesi në lidhje me pagimin e pagave të munguara të ankuesit është pezull në Gjykatën e Lartë. Ajo i kërkoi Gjykatës të pezullojë shqyrtimin e nenit 41 deri në daljen e vendimit të Gjykatës së Lartë. Ndërkohë që qeveria u zotua se do të dërgonte një tabelë me vlerësimin e pagave të prapambetura të ankuesit, deri tani nuk është dhënë asnjë informacion për këtë gjë.

65. Gjykata rithekson se një vendim në të cilin ajo gjen shkelje ngarkon mbi shtetin e paditur një detyrim ligjor për të përfunduar shkeljen dhe për të bërë riparimin e pasojave të saj sipas Konventës (shih, për shembull, Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë, nr.7352/03, § 110, 22 gusht 2006).

66. Ndërmjet çështjeve që Gjykata merr parasysh kur vlerësohet kompensimi janë dëmi material (humbja që pësohet si rezultat i drejtpërdrejtë i shkeljeve të pretenduara) dhe dëmi jomaterial (dëmshpërblim për ankthin, problemet apo pasiguritë e vuajtura si rezultat i shkeljes) dhe dëme të tjera jomateriale (shih, ndërmjet të tjerash, Ernestina Zullo kundër Italisë, nr.64897/01, § 25, 10 nëntor 2004). Për më tepër, nëse një ose më shumë zëra dëmi nuk mund të përllogariten saktë ose nëse dallimi ndërmjet dëmit material ose jomaterial është i vështirë të bëhet, Gjykata mund të vendosë të bëjë një vlerësim të përgjithshëm (shih Comingersoll kundër Portugalisë [GC], nr. 35382/97, § 29, ECHR 2000-IV).

67. Gjykata është e mendimit se çështja e dëmshpërblimit për moskthimin në detyrë të ankuesit mund të jetë e lidhur me procesin pezull para Gjykatës së Lartë në lidhje me pagat e humbura. Si rrjedhojë, Gjykata është e mendimit se çështja e zbatimit të nenit 41 në lidhje me dëmin material nuk është gati për vendim. Si rezultat, çështja duhet rezervuar dhe duhet të fiksohet procedura e mëtejshme në varësi të zhvillimeve të brendshme për procesin e pagave të munguara.

**B. Dëmi jomaterial**

68. Ankuesi kërkoi 1,500,000 lekë (rreth 12,260 euro) në lidhje me dëmin jomaterial. Qeveria nuk ra dakord me shumën e kërkuar nga ankuesi.

69. Gjykata pranon se ankuesi ka vuajtur nga stresi i cili mund të ishte shmangur nëse autoritetet do të kishin respektuar vendimin përfundimtar. Në këtë pikë, duke e bërë vlerësimin e saj mbi një bazë të barabartë, Gjykata i dha ankuesit 2,100 euro për dëmin jomaterial.

**C. Kostot dhe shpenzimet**

70. Ankuesi kishte marrë 850 euro si ndihmë ligjore nga Këshilli i Evropës në lidhje me prezantimin e kësaj çështje dhe kërkoi 162,194 lek (rreth 1,277 euro) për shpenzimet ligjore të dala nga proceset e brendshme ligjore. Ai ofroi dokumente mbështetëse në lidhje me postimin, tarifat ligjore dhe taksën e paguar për përmbaruesin për zbatimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit të datës 24 tetor 2006. Ankuesi kërkoi 3,665 euro për shpenzimet për shqyrtimin e çështjes në Strasburg. Për këtë qëllim, ai dorëzoi një faturë.

71. Qeveria kontestoi pretendimet e ankuesit për kostot dhe shpenzimet, duke u shprehur se tarifat ligjore të brendshme dhe të Strasburgut nuk bazoheshin në fatura të tatueshme të njohura zyrtarisht.

72. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, një ankues ka të drejtën e rimbursimit të kostove dhe shpenzimeve të tij vetëm për aq kohë sa është dëshmuar se këto kosto e shpenzime janë kryer realisht e kanë qenë të nevojshme dhe kur janë të arsyeshme në sasi (shih, për shembull, Xheraj, cituar më lart, § 85).

73. Në lidhje me kostot dhe shpenzimet për proceset e brendshme, Gjykata vë re se ajo është e kënaqur me tarifat e postimit siç janë pretenduar nga ankuesi. Ajo mendon se tarifat ligjore të dala në grupin e parë të proceseve ligjore janë të arsyeshme duke pasur parasysh informacionin që zotëron. Gjithsesi, ajo nuk pranon rimbursimin e tarifave ligjore dhe taksës së përmbaruesit për sa i përket grupit të dytë të proceseve, pasi e ka shpallur të papranueshme këtë ankim.

74. Në lidhje me kostot dhe shpenzimet për procesin në Gjykatën e Strasburgut, Gjykata vë re se kjo çështje nuk ishte komplekse. Për to, duke pasur parasysh jurisprudencën e saj, Gjykatës nuk ju desh kërkim i zgjeruar, dhe as nuk duhej ndonjë mbështetje e madhe në prova.

75. Në këto rrethana dhe duke pasur parasysh detajet e pretendimeve të parashtruara nga ankuesi, Gjykata i jep atij në lidhje me procesin e brendshëm dhe atë të Strasburgut 3,000 euro minus 850 euro të marra si ndihmë ligjore nga Këshilli i Evropës.

**C. Interesi i munguar**

76. Gjykata e mendon të arsyeshme se interesi i munguar duhet të bazohet në nivelin marxhinal të huasë së Bankës Qendrore Evropiane, mbi të cilën duhet të shtohen tre përqind.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME:

1. *Deklaron* ankimin sipas nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrës, të datës 24 tetor 2006 të papranueshëm.

2. *Bashkohet* me themelin e kundërshtimit paraprak të Qeverisë në lidhje me mosshterimin e mjeteve të brendshme juridike nga ankuesi përsa i përket vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit të datës 27 shtator 2005 dhe *e deklaron* pjesën tjetër të ankimit të pranueshëm.

3. *Vendos* se ka shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit të datës 27 shtator 2005.

4. *Vendos* se ka shkelje të nenit 13 në lidhje me nenin 6 § 1 të Konventës përsa i përket mungesës së mjeteve ligjore efektive për moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit të datës 27 shtator 2005 dhe rrjedhimisht *rrëzon* kundërshtimin paraprak të Qeverisë.

5. *Vendos:*

a) se shteti i paditur do t'i paguajë ankuesit, brenda tre muajsh nga data në të cilën vendimi bëhet përfundimtar sipas nenit 44 § 2 të Konventës, shumat e mëposhtme, të konvertuara në monedhën e shtetit të paditur, të aplikueshme në datën e pagimit:

i) 2,100 (dy mijë e njëqind) euro, plus çdo tatim që mund të vendoset në lidhje me dëmin jomaterial;

ii) 2,150 (dy mijë e njëqind e pesëdhjetë) euro, plus çdo tatim që mund të vendoset në lidhje me kostot dhe shpenzimet;

b) që prej skadimit të tremujorit të përmendur më lart deri në kryerjen e pagesës për ankuesin, do të paguhen interesa të thjeshtë mbi shumën e sipërpërmendur sipas një niveli interesi të barabartë me nivelin marxhinal të huasë së Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre përqind.

6. *Vendosi* që çështja e zbatimit të nenit 41 të Konventës në lidhje me dëmin material nuk është gati për vendim.

Si rezultat:

a) *e rezervon* këtë çështje;

b) *fton* Qeverinë e paditur dhe ankuesit të parashtrojnë, brenda tre muajve në vijim nga data kur vendimi bëhet përfundimtar, në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, vëzhgimet e tyre të shkruara për çështjen, dhe, në veçanti, të njoftojnë Gjykatën për zhvillimet e brendshme;

c) *rezervon* procedurën e mëtejshme dhe *i delegon* kryetarit të trupit gjykues kompetencën e fiksimit të kësaj çështjeje nëse është e nevojshme.

E bërë në anglisht dhe e njoftuar me shkrim në datën 29 shtator 2009, në përputhje me nenin 77 § 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

Lawrence Early
Sekretar

Nicolas Bratza
Kryetar

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,** në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

| | |
|---|---|
| KODI I PROCEDURËS CIVILE ..... | 240 lekë |
| KODI PENAL ..... | 226 lekë |
| KODI I PROCEDURËS PENALE..... | 330 lekë |
| KODI CIVIL ..... | 410 lekë |
| KODI I PUNËS ..... | 140 lekë |
| KODI PENAL USHTARAK ..... | 55 lekë |
| KODI I FAMILJES ..... | 270 lekë |
| KUSHTETUTA ..... | 95 lekë |
| KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE ..... | 90 lekë |
| PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE | 140 lekë |

Hyri në shtyp më 3.11.2009
Doli nga shtypi më 5.11.2009

| | |
|---|---|
| Tirazhi: 3300 copë | Formati: 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 22 lekë